



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.04/2017  
Prishtinë, më 02.11.2017, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Qëndron Kastrati, Mimoza Kusari – Lila, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

**I ftuar:** Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Rrezarta Ajeti dhe Ilir Imeri – ARKEP, Etleva Malushaj –GPP/ LVV, Artan Murati – KDI, Amir Kozmaqi dhe Dora Musa – INDEP dhe Sanie Jusufi – Koha Ditore.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.10.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016;
4. Formimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për energjinë elektrike;
5. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.10.2017**

*Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 24.10.2017, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016**

**Kryetarja** sqaroi se pas përfundimit të secilit vit Autoriteti paraqet raport vjetor brenda gjashtë mujorit të vitit vijues. Mirëpo, për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, ky raport po shqyrtohet tani në nëntor 2017. Kështu që çfarëdo rekomandimi që mund të japë Komisioni ARKEP do të duhet ta adresojë në këta dy muaj të mbetur të këtij viti, ose në vitin 2018. Ne, si komision, jemi këtu jo vetëm njëherë në vit me i dëgjuar, por edhe mund t'i vizitojmë dhe të shohim më në detaje punën e ARKEP-it. Për ta paraqitur raportin vjetor ia dha fjalën z. Kreshnik Gashit, kryetar i bordit të ARKEP-it.

**Kreshnik Gashi, kryetar i bordit të ARKEP-it**, pasi përshëndeti deputetët dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje, theksoi se raporti vjetor i punës afron të dhëna mbi të arriturat dhe angazhimet e Autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara me ligjet përkatëse, dokumentin e politikave të sektorit të komunikimeve elektronike, si dhe planin e punës. Po ashtu, raporti paraqet edhe një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit raportues, janë hartuar dhe miratuar një mori aktesh normative me karakter rregullator dhe me efekte strukturore në tregjet e rregulluara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti. Ka implementuar detyrimet, të cilat dalin nga marrëveshja e telekomunikacionit në mes Kosovës dhe Serbisë. Si rezultat më 15 dhjetor 2016 Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU) i ka caktuar Republikës së Kosovës kodet shtetërore: Kodin shtetëror “383” sipas Rekomandimit ITU-T, Kodin shtetëror mobil MCC 221 sipas Rekomandimit të ITU-së, dhe Kodin e sinjalizimit të zonës/rrjetit 7-214 sipas Rekomandimit të ITU-së. Po ashtu, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së Brukselit, ARKEP ka lëshuar një autorizim të përgjithshëm për afrimin e shërbimeve të telefonisë fikse, si dhe një autorizim të përkohshëm për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile dhe të kufizuar si në infrastrukturë ashtu edhe në numër të përdoruesve për ndërmarrjen “MTS D.O.O.”. ARKEP ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm të interpretimeve dhe/apo udhëzime për palët, kryesisht nga operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe atyre postare. Z. Gashi më tutje paraqiti të dhëna statistikore të aktiviteteve të ARKEP-it duke përfshirë autorizimet e dhëna, shqyrtimin e ankesave, inspektimet, masat ndëshkuese, monitorimet e kualitetit të shërbimeve, të hyrat dhe aktiviteteve të tjera. Ai theksoi se ARKEP ka arritur që me sukses të anëtarësohet në cilësinë e vëzhguesit, në “Institutin Evropian për Standardet Telekomunikuese (ETSI)”. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 është funksionalizuar njësi teknike për reagime ndaj emergjencave kompjuterike në kuadër të ARKEP (KOS-CERT), si dhe kanë vazhduar aktivitetet për përgatitjet e nevojshme rreth aplikimit për kodin shtetëror të internetit. Në vazhdim, z. Gashi potencoi edhe masat që janë marrë në kuadër të adresimit të rekomandimeve

që ka miratuar Kuvendi gjatë shqyrtimit të raportit paraprak. Ndër sfidat kryesore të ARKEP që kanë vazhduar të jenë gjatë vitit 2016, ai përmendi, pavarësinë dhe kapacitetet e ARKEP, referuar mungesës së pavarësisë financiare të ndikuar nga miratimi i buxhetit; ballafaqimi që nga themelimi i institucionit, është anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare dhe marrja e kodeve shtetërore (ccTLD, ISO 3166); zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjeteve dhe shërbimeve brezgjëra të komunikimeve elektronike dhe arritja e objektivave të Agjendës Digjitale; rritja e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike; avancimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve fundor; implementimi i mekanizmave që garantojnë mbrojtje të konkurrencës.

**Kryetarja** falënderoi përfaqësuesin e ARKEP-it për prezantimin dhe pyeti: çka ka ndikuar shkurtimi i buxhetit në punën e ARKEP-it? Cilat projekte kapitale janë realizuar? Pse nuk janë shqyrtuar disa ankesa të konsumatorëve të shërbimeve postare? A ka një sistem të brendshëm të menaxhimit të ankesave?

**Dardan Sejdiu** theksoi se raporti nuk jep krahasime, shpjegime për rënien në investime, mbulueshmërinë me shërbime, krahasime me vendet e rajonit. Raporti nuk përmbledh problemet reale që ka ky sektor, dhe do të duhej të paraqiteshin problemet në raport. Ai potencoi se ARKEP duhet të jetë rregullator i pavarur siç e ka edhe në mision, e jo zbatues i marrëveshjeve të Qeverisë. Po ashtu është vërtetuar se pronarë i operatorit “MTS” që është autorizuar sipas marrëveshje është Serbia. Është fakt që me “kodin 383” thirrjet me Serbinë konsiderohen thirrje lokale. Ai pyeti se çfarë masa janë ndërmarrë që me u siguruar me zbatuar misionin që ka ARKEP-i? Pse po çalon operatori publik me investime? Çka po ndodh me operatorin publik? Ai kërkoi të sqarohet siguria nacionale e sektorit të komunikimeve elektronike.

**Dardan Molliqaj** potencoi se bordet nuk janë të pavarura, por janë politike, dhe tre prej pesë anëtarëve të bordit janë krejtësisht politik. Ligji thotë të bëhet statuti dhe rregullorja e punës, a e keni bërë statutin dhe rregulloren? Sipas raportit të auditorit ka probleme në rekrutim të personelit, punësime pa procedurë, nuk keni kontratë për shërbime të “Valës”, keq menaxhimi i automjeteve. Ai pyeti përfaqësuesit e ARKEP-it se ku janë vështirësitë në përmbushjen e gjetjeve të auditorit?

**Memli Krasniqi** tha se raporti paraqet punën e ARKEP-it për 2016, ndërsa potencoi se raportin e auditorit nuk e kemi në shqyrtim sot, por raportin e punës së ARKEP-it dhe për këtë çështje është një komision tjetër parlamentar që merret me raportet e auditorit. Ai kërkoi që pavarësia financiare të arrihet, resurset e personelit të jenë të krahasueshme me të rajonit, ankesat për shërbime postare të sqarohen. Ai theksoi se ARKEP ka obligim të zbatojë detyrimet e veta të cilat burojnë nga marrëveshja e Kosovës me Serbinë. Problem janë të gjeturat e auditorit dhe duhet të adresohen.

**Bilall Sherifi**, pyeti pse operatori “VALA” dhe “IPKO” nuk janë në veri të vendit?

**Dardan Sejdiu** pyetje plotësuese, se a kanë të drejtë me operuar në veri të vendit operatori “VALA” dhe “IPKO” sepse ka pasur diskriminim ndaj “Valës” dhe “IPKO-s”. Po ashtu, pyeti

se a operon operatori serb në veri të Kosovës? Sa numra i janë dhënë “MTS-së”? Në sa pika shitet? Cila është mbulueshmëria që ka “MTS”?

**Kreshnik Gashi**, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, theksoi se raporti nuk paraqet vetëm anët pozitive, por potencon edhe sfidat, vështirësitë dhe problemet. Raportin financiar edhe të gjeturat e Auditorit i kemi paraqitur në mënyrë të përmbledhur në raport pasi ato janë edhe raporte të veçanta. Për vitin 2016 kanë qenë të planifikuara 90 mijë euro investime kapitale, janë shpenzuar 60 mijë, 30 mijë jo. Ankesat e konsumatorëve të shërbimeve postare janë ankesa që fillimisht i kanë shkuar operatorëve e që operatorët nuk i janë përgjigjur, ARKEP-i është përgjigje në të gjitha ankesat. Raporti ka krahasime me vitet paraprake dhe me vende tjera, të dhëna edhe më të detajuara ka në raportet tremujore. Ne nuk e konsiderojmë vetëm instrument të Qeverisë, por ne kemi obligim për opinion profesional dhe mbështetje profesionale të organeve shtetërore. “Kodi 383” është kod i vetëm dhe me implementimin e “Kodit 383” hiqen të tjerat, deri në qershor 2018, ky kod do të implementohet plotësisht. Siguria e komunikimeve elektronike ekziston. Lidhur me operatorin publik, ARKEP trajton barabartë operatorët publik dhe privat. Rënia është edhe pasojë e aplikacioneve të tjera të komunikimeve. Lidhur me bordet me rëndësi të jenë profesionale, janë zgjedhur sipas procedurave ligjore, dhe i plotësojnë kërkesat ligjore. Nga gjetjet e Auditorit vetëm një është e prioritetit të lartë, ndërsa të tjerat me prioritet të mesëm dhe ne auditorin e trajtojmë si partner. Kah mesi i shtatorit e kemi miratuar statutin e cila ka qenë gjetje e Auditorit, dy gjetje janë përmbushur të tjerat janë në proces. “VALA” dhe “IPKO” kanë të drejtë të operojnë në çdo cep të Kosovës. Sa i përket operatorit në veri të vendit kemi një operatorë me shtrirje të caktuar në bazë të marrëveshjes, është operatorë i kufizuar. Në bisedime me Serbinë për telekomunikacionin kanë qenë edhe përfaqësues të “Valës” dhe “IPKO-s” dhe ka pasur transparencë. Operatori “MTS” ka ekzistuar në veri në mënyrë ilegale, kanë ekzistuar edhe dy operatorë të tjerë, por ata nuk ekzistojnë më.

**Illir Imeri – ARKEP**, theksoi se me ligj jemi të detyruar me i zbatuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe po ashtu edhe këtë marrëveshje. Operatori “MTS” ka paguar tri pagesa që janë obligim për të operuar. Ky operator është i përkohshëm dhe maksimum mundet të merr 60 mijë numra, dhe mund të vendoset në 30 lokacioneve, prej të cilave shumica janë në veri.

*Në mungesë të kuorumit, kryetarja ndërpreu mbledhjen.*

\* \* \*

**Vazhdimi i mbledhjes më 7.11.2017, në orën 11:00 salla S-1, ndërtesa e Kuvendit.**

**Pjesëmarrës/Komisioni: Sala Berisha – Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.**

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.**

**Kryetarja** tha se po e vazhdojmë mbledhjen e ndërprerë më 2.11.2017, për shkak të mungesës së kuorumit dhe po vazhdojmë më pikën e rendit të ditës “Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016”. Lidhur më këtë pikë është shter debati më 2.11.2017, dhe i ftoj deputetët për votim.

*Komisioni me 5( pesë) vota për dhe 1 (një) abstënim, nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

*I. Të miratohet Raporti vjetor për vitin 2016, i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP);*

*II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputetja Sala Berisha – Shala, kryetare.*

#### **4. Formimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për energjinë elektrike**

**Kryetarja** tha se jemi pajtuar me Plan të punës që ta bëjmë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për energjinë elektrike. Dhe hapi debat.

**Hykmete Bajrami** tha se para se ta bëjmë mbikëqyrjen e zbatimit të një ligji do duhej ta kemi një analizë se pse duhet ta bëjmë këtë veprim, apo pse duhet ta mbikëqyrim zbatimin e një ligji të caktuar.

**Bilall Sherifi** tha se këtë temë e kemi diskutuar kur e kishim Planin e punës dhe prej dy ligjeve që u diskutuan cilën ta mbikëqyrim, pra Ligjin për patentë shofer apo ligjin për energjinë elektrike, u pajtuam që ta bëjmë këtë të fundit, madje me propozim të zëvendëskryetarit z. Dardan Sejdiu.

**Kryetarja** propozoi që këtë grup ta udhëheqë z. Sejdiu edhe është pjesë e opozitës, dhe ta vendosim si rregull që grupin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve ta udhëheqë opozita.

*Pas debatit Komisioni, nxori këtë:*

### **V E N D I M**

- 1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Dardan Sejdiu, kryesues, Sala Berisha - Shala dhe Hykmete Bajrami, anëtarë, si dhe kërkohet që anëtarë GP AAK dhe nga GP të minoriteteve të dërgojnë përfaqësuesit e tyre;*
- 3. Grupi punues në bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

#### **5. Të ndryshme;**

Çështjet vijuese.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:15.**

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetare e komisionit,**

-----

**Sala Berisha – Shala**